



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0848**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “RISAMONT” SH.P.K., OE “BESA COMPANY” SH.P.K., OE “MB POWER” L.L.C., si dhe “INLINE ENGINEERING” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “122 Ndertimi, zgjerimi dhe modernizimi I rrjetit të ndriçimit publik” me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, me 03/12/2024, mori:

### **Vendim**

1. **Aprovohen, si pjesërisht të bazuara** ankesa e OE “Risamont” Sh.P.K. me numër 2024/0848 si dhe OE “Besa Company” Sh.P.K. me numër 2024/0850 si dhe OE “MB Power” Sh.P.K. me numër 2024/0851 si dhe OE “Inline Engineering” Sh.P.K. me numër 2024/0855, të gjitha të parashtruara kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” Lot 2, 3 dhe 4 me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2. **Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 30.08.2024.

3. Me qenë se ankesa e operatorve ekonomik ankues aprovohen si pjesërisht të bazuara, të njëjtteve iu kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me datë 05.04.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi

dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” Lot 2, 3 dhe 4 me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar për Lot. 2 - 550,000.00, Lot. 3 - 350,000.00, dhe Lot. 4 - 345.000.00€.

Me datë 30.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit janë rekomanduar për kontratë për Lot 2 - OE “Infinet Lighting”, për Lot 3 OE "Javna Razvetjava d.d. Branch in Kosova”, për Lot 4 OE "M.VR Elektromontues".

Me datë 04.09.2024, OE ankues “Risamont” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 06.09.2024. Me datë 13.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0848.

Me datë 03.09.2024, OE ankues “Besa Company” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 06.09.2024. Me datë 13.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0850.

Me datë 03.09.2024, OE ankues “MB Power” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 06.09.2024. Me datë 13.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0851.

Me datë 03.09.2024, OE ankues “Inline Engineering” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 06.09.2024. Me datë 16.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0855.

*- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Risamont” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0848 janë parashtruar si në vijim:

**Pretendimi nr. 1 – LOT 2:** *“nuk janë plotësuar kërkesat teknike të kërkuara në DT, konkretisht për jetëgjatësinë e trupit ndriçues është kërkuar të jetë: jetëgjatësia e ndriçuesit*

$\geq 100.000 H$ , ndërsa produkti i OE të rekomanduar për kontratë ka jetëgjatësinë: Lifetime: 50,000H”.

**Pretendimi** – LOT 2: “*ëzuar sipas DT*”

**Pretendimi nr. 3** – LOT 2: “*Automjeti korpa me targa: 03-917-IF me marrëveshje Për pajisjen e lartcekur nuk është prezantuar ndonjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon në lartësi ngritëse  $\geq 10$  metra lartësi, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së Pretendimi tjetër ka qenë që Eskavatori në targa 01-111-VA është i ç regjistruar – jashtë përdorimit. Andaj edhe në këtë rast nuk është plotësuar kërkesa e AK-së rreth pajisjeve të regjistruara që duhet të jenë me librezë me validitet*”.

**Pretendimi nr. 4** - LOT 2: “*Kamioni me vinç me targa 01-218- Për pajisjen e lartcekur nuk janë ofruar dëshmi dokumentare se automjeti vinç operon me peshë mbajtëse  $\geq 10$  metra lartësi sipas kërkesës së AK*”.

**Pretendimi nr. 5** - LOT 2: “*Kamioni kiper me targa 01-05-2921, regjistrimi i fundit . Pra paisja e lartcekur është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit sepse e njëjta nuk posedon regjistrim valid*”.

**Pretendimi nr. 6** - LOT 2: “*OE i rekomanduar nuk ka prezantuar sipas DT - Automjeti korpa me targa: 01-137-UD me marrëveshje*”

**Pretendimi nr. 7** - LOT 2: “*OE i rekomanduar nuk ka prezantuar sipas DT - Ngarkues me lopate VOLVO BEL 71 me*”

**Pretendimi nr. 8** - LOT 2: “*Oferta financiare (pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar për kontratë, nuk ndryshon nga ofertat financiare të OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, respektivisht në gjithsej 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kanë çmime jo-normalisht të ulëta, ndërsa pozicione të caktuara kanë çmime tej normalisht të larta, mirëpo përmes formimit të çmimeve për pozicione, atëherë vije deri te arsyeshmëria teknike-financiare. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka bërë manipulime në çmime, ku në disa pozicione ka dhënë çmime jo normalisht të ulëta, ndërsa në disa pozicione tjera ka dhënë çmime tej normalisht të larta të cilat nuk përkojnë me çmimet e tregut. Autoriteti kontraktues është dashur të analizojë në tërësi të gjitha çmimet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të veprojë konform dispozitave të nenit 61 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë. AK ka qenë i njëanshëm në trajtimin e ofertave, sepse neve na eliminon për çmime jo-normalisht të ulëta edhe pse ne i kemi çmimet e tregut dhe mund të arsyetojmë të gjitha, kurse në anën tjetër rekomandon për kontratë një OE i cili ka vendosur çmime manipulative, e për më tepër nuk kërkon as sqarime*”.

**Pretendimi nr. 9** – LOT 3: “*Kontrata e renditura me numrat rendor: 1 dhe 2, janë kontrata të periudhës kohore 2019- 2020, andaj të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, ndërsa vetëm kontrata me numër rendor: 3 e vitit 2022 është e vlefshme dhe ka vlerën: 425,395.00€*”.

**Pretendimi nr. 10** – LOT 3: “*Për kërkesën e lartcekur OE i propozuar për kontratë ka prezantuar autorizim nga dy prodhues të ndryshëm: UNICOMLITE dhe DIECASTINGMANLIGHT.*”

*Produkti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e DT, pasi që jetëgjatësia e trupit ndriçues është kërkuar të jete: Jetëgjatësia e ndriçuesit  $\geq 100.000$  h, ndërsa është ofertuar: Lifetime: 50,000H. Mostra e dorëzuar nuk disponon me të dhënat bazike të prodhuesit si dhe me të dhënat tjera të duhej të ishin konform të dhënave teknike të produktit të ofertuar me katalog”.*

**Pretendimi nr. 11** – LOT 4: *“pajisjet vijuese nuk janë në përputhje me DT - Automjeti korpa me targa: 01-723- Kamioni kiper me kran me targa 01-507- ZD me regjistrim Eskavator JCB 4 Automjeti korpa me targa;01-755-*

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Company” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0850 janë parashtruar si në vijim: *“Autoriteti Kontraktues nuk e ka ngarkuar përmes platformes njoftimin sipas nenit 30.4 ku thote (citim): Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).duke e shkëlur nenin 30.4 të Rregullores për Prokurim Publik, na ka diskriminuar duke e favorizuar OE e preferuar me çmim shume me të shtrenjte se oferta jonë”.*

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MB Power” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0851 janë parashtruar si në vijim: *“AK e ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave për shkak të disa rrethanave me datë 19.07.2024 përmes emailit ([nexhmi.mekolli@rks-gov.net](mailto:nexhmi.mekolli@rks-gov.net)) mirëpo AK nuk e ka kërkuar përmes platformës kërkesën për zgjatje ashtu sikurse e kërkon RRPP”.*

**Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inline Engineering” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0855 janë parashtruar si në vijim: *“Në lidhje arsye e eliminimit tonë, AK-ja ka dhënë një përgjigje të përgjithësuar, duke mos e sqaruar se çka nuk kemi plotësuar për stafin teknik e çka për makineritë, andaj kjo arsye tregon qartë diskriminimin që po na bëhet neve si kompani. Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme për faktin se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat për stafin teknik e po ashtu edhe kërkesat në lidhje me mjetet mekanike të kërkuara. Kur analizohen dëshmitë e prezantuara nga ana jonë mund të vërtetohet qartë se ne në ofertë tek lista e punëtorëve posedojmë komplet stafin të cilin e kemi të rregullt dhe stafin i cili është i angazhuar sipas nevojave të projektit. Ne lidhje me stafin ne i kemi bashkangjitur diplomat, kontratat, CV dhe referencën e inxhinierit. Sa i përket pajisjeve AK-ja tani e ka cekur se kinse neve na mungon dëshmia e pronësisë së eskavatorit me qiradhënësin Murseli Company, mirëpo edhe ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm sepse ne i posedojmë të gjitha dokumentet sipas kërkesës së AK-së. AK-ja këtë arsye nuk e kishte cekur në njoftimin mbi vendimin e saj, mirëpo tani po mundohet që me veprime të tilla duke shtuar arsye të eliminimit edhe pse të njëjtat janë të pa baza, të na cilësoj kinse si OE të papërgjegjshëm. Vlen të ceket fakti se edhe nëse do të mungonte një dëshmi e tillë atëherë AK-ja do të duhej të kërkonte sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe pse ka qenë e panevojshme sepse ne e përmbushim kërkesën e dosjes.Trupi ndriçuesi i ofertuar nga OE rekomanduar për LOT 2 dhe LOT 3 nuk është prezantuar sipas parametrave teknike të kërkuara dhe është shume me i lirë se ai i kërkuar nga AK, për arsye se jetëgjatësia është për 50% me e ulët”.*

**- Vlerësimi dhe administrimi i provave -**

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues ndërsa me datë 26.09.2024 ka autorizuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0848 ndërsa me datë 23.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues si dhe me datë 26.09.2024 ka autorizuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 2024/0850, 2024/0851 si dhe 2024/0855. Raportet e ekspertizave janë dorëzuar me rregull dhe kanë prezantuar rekomandimin si vijon: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”*.

**Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Risamont” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0848 janë prezantuar si në vijim:

**Pretendimi nr. 1** – *“Eksperti teknik, pas administrimit të dokumentacionit dhe kërkesave të DT, thekson se sipas karakteristikave të kërkuara në DT dhe pas shqyrtimit të ofertës së OE të rekomanduar, shihet se jetëgjatësia e prezentuar këtë dokument nuk janë komfor kërkesave të DT. Prandaj sipas shpjegimeve të mësipërme eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor në këtë çështje është i bazuar”*.

**Pretendimi nr. 2** – *“Nga inspektimi në AK për kontrollimin e mostrave nuk kam vërejtur se ka pas të vendosura në stiker me ngjitës në mostrën e produktit, prandaj eksperti teknik pretendimi i OE ankues është i pabazë”*.

**Pretendimi nr. 3** – *“Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar Librezën e Automjetit korpa me targa: 03-917-IF me marrëveshje shfrytëzimi me Ermal Cacaj, por që nuk ka ndonjë dëshmi që në çfarë lartësie ngritëse operon shporta. Eksperti shqyrtues ka analizuar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se në librezën që është bashkangjitur për këtë Eskavator shkruan se Automjeti i çregjistruar 01-111-VA, 11.10.2023 ETM Group SHPK dhe nuk ka ndonjë dëshmi tjetër se është me regjistrim valid kjo ”*.

**Pretendimi nr. 4** – *“Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar Librezën e Automjetit Kamioni me vinç me targa 01-218-JJ, por që nuk ka ndonjë dëshmi që në çfarë lartësie ngritëse operon kamioni me pesh mbajtëse”*.

**Pretendimi nr. 5** – *“Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se në listen e paisjeve të dorëzuar nuk ka mundur ta gjej këtë dëshmi në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe nuk mund të jap ndonjë konstatim për këtë pretendim”*.

**Pretendimi nr. 6** – *“Automjeti korpa me targa: 01-137-UD me marrëveshje Për pajisjen e lartcekur nuk është prezantuar ndonjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon në lartësi ngritëse  $\geq 10$  metra lartësi, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar Librezën e*

*Automjetit korpa me targa: 01-137-UD, por që nuk ka ndonjë dëshmi që në çfarë lartësie ngritëse operon korpa”.*

**Pretendimi nr. 7** – “Ngarkues me lopate VOLVO BEL 71 me Kërkesa e AK ka qenë: Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa, ndërsa për këtë pajisje nuk janë prezantuar dëshmi konkrete ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit, Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar Kontratën për shfrytëzim me **Menti shpk**, dhe DUD doganor, mirëpo nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi se ekskavatori është 4x4”.

**Pretendimi nr. 8** – “Në lidhje me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta, eksperti shqyrtues konstaton se nuk është zbatuar neni 61 i LPP-së, prandaj në lidhje me çmimet duhet zbatuar procedura sipas nenit 61 ët LPP dhe eventualisht të kërkohej sqarime për çmimet që duken jonormalisht të ulëta. Në lidhje me arsyen **eliminimit të OE ankues risamont** për çmime jo normalisht të ulëta, eksperti shqyrtues konstaton se është i qëndrueshëm pretendimi se i janë kërkuar sqarime paraprakisht OE ankues, ndërsa sa i përket arsyes së eliminimit mendojë duhet të zbatohet neni 61 i LPP-dhe neni 41 i RRPP për të gjithë ofertuesit në mënyrë të barabartë, pasi që me çmime pothuajse janë afërsisht të njëjta me dallime të vogla. Arsyeya tjetër për eliminimin të OE ankues ka qenë se “Nuk është përmbushur kërkesa 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional ne DT. Mungone pese punonjes teknik me SSHP, CV, Kontrate dhe diploma. Vetem per 3 punonjes jane dorezuar dokumentet e kompletuara. Në lidhje me këtë pretendim eksperti shqyrtues konstaton se mungojnë në dosje kontrata dhe mirëpo në dosje janë bashkangjitur listat e ATK prandaj mund të kërkohej sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP edhe pse kontratat dhe Cv i ka bashkëngjitur me ankesë”.

**Pretendimi nr. 9** – “Pas konstatimit dhe shqyrtimit të ofertës, Eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontrat ka plotësuar aneksin 6, ku figurojnë tri kontrata dhe referenca respektive, por i njëjti sqaron se dy nga këto kontrata nuk e përmbushin kërkesën e AK sipas DT, pasi që janë të vitit 2019-2020, andaj nëse e marrim vetem njëren kontrat të vitit 2022, prezantuar në këtë list del që nuk e ka përmbushur kërkesën për Lot 3, ku është kërkuar kontrata të jetë në vlerë minimale 500,000.00 Euro”.

**Pretendimi nr. 10** – “Lidhur me pretendimin , OE ankues pretendon se nuk janë plotësuar kërkesat teknike të kërkuara në DT, konkretisht për jetëgjatësinë e trupit ndriçues është kërkuar të jetë: jetëgjatësia e ndriçuesit  $\geq 100.000$  h, ndërsa produkti i OE të rekomanduar për kontratë ka jetëgjatësinë 50,000H. Po ashtu për Ndriçuesi i LED-it:  $\geq 150$  lm/W, ndërsa është ofertuar 120 lm/W si janë kërkuar fuqitë: 50W, 100W dhe 150W, ndërsa janë prezantuar fuqitë: 40W, 60W dhe Eksperti teknik, pas administrimit të dokumentacionit dhe kërkesave të DT, thekson se sipas karakteristikave të kërkuara në DT dhe pas shqyrtimit të ofertës së OE të rekomanduar, shihet se jetëgjatësia dhe fluksi i ndriçimit e prezentuar këtë dokument nuk janë komfor kërkesave të DT. Prandaj sipas shpjegimeve të mësipërme eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor në këtë çështje është i bazuar”.

**Pretendimi nr. 11.** – “Automjeti korpa me targa: 01-723- Për pajisjen e lartcekur nuk është prezantuar ndonjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse  $\geq 10$  metra lartësi, sipas kërkesës se AK. Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën

e tij ka prezantuar. Librezën e Automjetit korpa me targa: 01-723-LI me marrëveshje shfrytëzimi me Ermal Cacaj, por që nuk ka ndonjë dëshmi që në çfarë lartësie ngritëse operon shporta. Kamioni kiper me kran me targa 01-507-ZD me regjistrim Kërkesa e AK ka qenë: Kamion vinç me peshë mbajtëse  $\geq 10$  metra lartësi, ndërsa është prezantuar kamion kiper me kran. Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar KONTRATË MBI QIRADHËNIEN E KAMIONIT ME VINÇ DHE KAMIONIT KIPER me K.n.p.sh “Papenburg & Adriani Company sh.p.k” NR identifikus.810652942, adresa Lipjan-Grack, përfaqesuar nga Muhamet Dërvishi, mirëpo nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi se automjeti është vinç dhe se operon peshë mbajtëse  $\geq 10$  metra Eskavator JCB 4 Përveq marrveshjeve dhe dudit duganior, nuk është prezantuar ndonjë foto e pajisjes ashtu siç është kërkuar nga AK. Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar KONTRATË MBI QIRADHËNIEN E ESKAVATORIT 4x4, E lidhur me 03.05.2024 ne mes palëve kontraktuese dhe ate: 1. “Delta – ing” sh.p.k NR identifikus. 810444646, adresa Prishtine, përfaqesuar nga Drejtori Emri Sopjani nga ana tjetër si qiradhënes. 2. N.sh “M.v.r Elektromontues” NR Identifikus. 810898231, adresa Prishtinë-Hajvali përfaqësuar nga Drejtori Shukri Vitija, si dhe ka bashkangjitur dudin duganor, mirëpo nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi tjetër të paisjes se ekskavatorit. Automjeti korpa me targa;01-755- Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse  $\geq 10$  metra lartësi sipas kërkesës se AK. Në lidhje me këtë pretendim të OE ankues, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar ofertën e këtij OE të rekomanduar për kontratë dhe konstaton se ky OE në ofertën e tij ka prezantuar Librezën e Automjetit Kamioni me vinç me targa 01-755-LT, por që nuk ka ndonjë dëshmi që në çfarë lartësie ngritëse operon kamioni me peshë mbajtëse. Arsye të eliminimit si në vijim “Nuk eshte kerkesa e DT lidhur me pasjjet dhe makinerite e kerkuara. Kjo sepse kamioni me kran nuk eshte i regjistruar me libreze ndersa kamioni me kiber nuk ka Eksperti shqyrtues konstaton se Libreza e kamionit me kran me targa 01-146-LD me regjistrim: 14.06.2024 është e bashkangjitur dhe me datën e ofertimit ka pasur validitet të librezës. Eksperti shqyrtues konstaton se Libreza e kamionit kiper me targa 01-611-MR e bashkangjitur ne listën e pajisjeve ka regjistrim deri me dt.10.05.2023, OE ankues shihet se librezën me regjistrim ja ka bashkangjitur bashk me kërkesen për sqarim ku vërehet se Libreza e kamionit kiper me targa 01-611- MR ka regjistrim deri me dt. 10.05.2025, prandaj ky pretendim është i bazuar”.

**Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Company” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0850 janë prezantuar si në vijim: “Në lidhje me pretendim e OE ankues se AK e ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave, me date 19.07.2024 permes emailit (Nexhmi.Mekolli@rksgov.net), mirepo AK nuk e ka kerkuar permes platformes kerkesen per zgjatje te afatit ashtu siq e kerkon Rregullorja nr.01/2022, por zyrtari ne fjale Nexhmi Mekolli e ka bere permes emailit, eksperti shqyrtues konstaton se në e prokurim nuk shihet se është bërë kërkresa për zgjatje të validitetit ashtu siç përcaktohet në Nenin 30.4 të RRPP, kurse nga shkresat e lëndës vërtetohet se kërkesa për zgjatje është bërë përmes emailit siç ka cek OE ankues”.

**Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MB Power” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0851 janë prezantuar si në vijim: “Në lidhje me pretendim e OE ankues se AK e ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave, me date 19.07.2024 permes emailit (Nexhmi.Mekolli@rksgov.net), mirepo AK nuk e ka kerkuar permes platformes kerkesen per zgjatje te afatit ashtu siq e kerkon Rregullorja nr.01/2022, por

zyrtari ne fjale Nexhmi Mekolli e ka bere permes emailit, eksperti shqyrtues konstaton se ne e prokurim nuk shihet se eshte bere kerkesa per zgjatje te validitetit ashtu sic percaktohet ne Nenin 30.4 te RRPP, kurse nga shkresat e lendes vertetohet se kerkesa per zgjatje eshte bere permes emailit ashtu sic e ka cek OE ankues”.

**Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inline Engineering” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0855 janë prezantuar si në vijim: “Eksperti ka konstatuar se OE i ka bashkangjitur listen e punëtorëve si dhe certifikaten e siguris për tetë (8), puntorë, me këtë dëshmon që e ka përmbush kërkesen e AK, ku në DT autoriteti kontraktues te pika e 7.3. ka kërkuar që për LLot 2.3 dhe 4 kërkohet minimumi 5 punëtor të cilët duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë. Andaj, duke e pasur parasysh këtë pretendim, eksperti shqyrtues konstaton se AK pa të drejt e ka eliminuar OE ankues në lidhje me këtë pikë, pasi që u konstatua se është eliminuar pa të drejt, pasi që OE e plotëson këtë kërkesë. Andaj, Eksperti shqyrtues rekomandon që të aprovohet ky pretendim ankimor si i bazuar. Ndërsa sa i përket sqarimit të OE ankues për piken e eliminimit lidhur me paisjet/makinerisë. Eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE ankues në ofertën e tijë ka dorëzuar listën e paisjeve si dhe marrveshjen për shfrytëzimin e mjeteve me kompanin "Company Murseli", por nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të pronësis ashtu siq është kërkuar në DT. Andaj eksperti shqyrtues mendon që, kjo pik e ankeses të aprovohet si pjesërisht e bazuar si dhe rekomandohet AK që gjatë rivlersimit para se ta eliminoj OE ankues duhet të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP”.

Duke marrë parasysh faktin se ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0848/2024, 0850/2024, 0851/2024 si dhe 0855/2024 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

#### **- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -**

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave



tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

**Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Risamont” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0848 është gjetur si në vijim: sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye se AK ka konstatuar që ofertuesi ka dorëzuar çmim jonormalisht të ulët. Po ashtu sipas AK nuk janë përmbushur kërkesat për personelin pasi që mungojnë 5 teknik me SSHP, CV, Kontratë dhe diploma (janë dorëzuar vetëm 3 të kompletuar). Po ashtu kamioni me kran nuk është i regjistruar me librezë ndërsa kamioni me kiper nuk ka regjistrim. Përmes nenit 41 par. 1 të RRPP përcaktohet se *“Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”*. Tutje përmes nenit 41 par. 3 të RRPP përcaktohet se çmimi jonormalisht i ulët ndër të tjera konsiderohet edhe atëherë kur *“çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”*. Vlen të thuhet se AK para se të konfirmoj që çmimi i parashtruesit është jonormalisht i ulët, ka zhvilluar procedurë inter partes me parashtruesin ashtu që ka kërkuar sqarime shtesë në kuptim të nenit 41 par. 2 dhe 41 par. 6 të RRPP ku përcaktohet se *“Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët”*. Përndryshe nuk kontestohet nga parashtruesi që AK ka kërkuar sqarime për çmimin jonormalisht të ulët me datë 05.06.2024. Nga ky këndvështrim, duhet theksuar po ashtu që për Panelin Shqyrtues nuk është kontestues fakti që çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimeve dhe dukshëm më i ulët sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Në anën tjetër AK ka kompetencën e plotë ligjore që në përputhje me nenin 41 të RRPP të nxjerr konstatimin që një ofertë përmban çmim jonormalisht të ulët nëse plotësohen kushtet ligjore sikurse në rastin konkret. Për këto

arsye Paneli Shqyrtues ka gjetur se kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar pasi që parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme përderisa ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta në kuptim të nenit 41 të RRPP. Sa i përket pikës së pretendimit ankimor lidhur me stafin, Paneli Shqyrtues ka gjetur se mungojnë 5 punonjës teknik me SSHP, CV, kontratë dhe diploma pasi që vetëm për 3 punonjës janë dorëzuar dokumentet e kompletuara. Rrjedhimisht nuk është përmbushur as kjo kërkesë e DT. Pra nga cilido këndvështrim, për Panelin Shqyrtues nuk është kontestues fakti që parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për çka edhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Sa i përket pretendimeve nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10 dhe 11, fillimisht duhet cekur se të gjitha këto pretendime janë drejtuar kundër tenderuesve të tjerë. Mirëpo, përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Rrjedhimisht në rast të rivlerësimit, qoftë epilogu i njëjti por edhe cilido epilog tjetër i aktivitetit të prokurimit nuk do të manifestonte interesin juridik të parashtruesit si tenderues i papërgjegjshëm. Sidoqoftë, sa i përket pretendimeve të parashtruesit *“Risamont”* por edhe të ankuesve të tjerë lidhur me jetëgjatësinë e një trupe ndriçuese jo me 100,000h por 50,000h, Paneli Shqyrtues sqaron se ky fakt përbën devijim të vogël në kuptim të nenit 45.19 të RRPP ku përcaktohet se *“Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur”*. Në rastin konkret ky detaj nuk afekton në asnjë formë aspektet materiale dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit prandaj në këtë pikë pretendimet ankimore janë të pabazuara për të gjithë ankuesit. Sa i përket pretendimeve ankimore 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 11 ku thuhet se disa nga pajisjet nuk kanë regjistrim valid, Paneli Shqyrtues ka gjetur se eksperti nuk ka vërtetuar faktin që në kohën e ofertimit pajisjet si të tilla kanë pasur regjistrim. Fakti që atyre pajisjeve ka mundur të ju skadoj regjistrimi në ndërkohë nuk mund t’i atribuohet fajit të OE dhe as nuk mund të supozohet që OE nuk ka vazhduar regjistrimin e tyre. Përndryshe AK nëse e konsideron të nevojshme ka kompetencën e nevojshme ligjore që të kërkoj sqarime shtesë në këtë aspekt. Sa i përket pjesëve të pretendimeve ankimore ku thuhet se për disa nga këto pajisje nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që janë kërkuar përmes DT, Paneli Shqyrtues sqaron se komisioni vlerësues në kuadër të AK ka pavarësinë dhe diskrecionin e plotë ligjor që të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave në përputhje me LPP. Përderisa nuk ekzistojnë argumente që pajisjet në fjalë nuk i përmbushin kërkesat e DT, mbetet në diskrecionin e AK që të vlerësoj nëse pajisjet në fjalë janë në përputhje me kërkesat e evidentuara në dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit 9 ku eksperti shqyrtues konstaton se tenderuesi i rekomanduar për lot 3 nuk ka përmbushur kërkesën e DT për kontrata dhe referenca në vlerë së paku 500,000.00 euro, Paneli Shqyrtues sqaron se AK nuk ka kërkuar kontrata dhe referenca të

realizuara në 3 vitet e fundit pasi që në kërkesën e DT askund nuk potencohet periudha 3 vjeçare por kërkesa e DT vetëm potencon që kërkon kontrata dhe referenca në vlerë së paku gjysmë milioni euro me ç'rast duhet plotësuar lista e kontratave dhe duhet të dorëzohen referencat përkatëse. Në rastin konkret tenderuesi ka dorëzuar edhe listën por edhe ka bashkangjitur referencat të cilat tejkalojnë dukshëm shumën prej 500,000.00 euro. Në këtë mënyrë është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit prandaj ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit 2 lidhur me mostrat Paneli i ka falur besimin ekspertit shqyrtues ku thuhet se mostrat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt.

**Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Company” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0850 si dhe **lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MB Power” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0851, është gjetur si në vijim: në rastin konkret nuk është fare kontestues fakti që autoriteti kontraktues ka kërkuar zgjatjen e validitetit të ofertës. Tutje nuk është kontestues as fakti që parashtruesit nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës përkatësisht nuk kanë konfirmuar vazhdimin e validitetit të ofertës. Po ashtu nuk është kontestues as fakti që mungesa e konfirmimit për vazhdimin e validitetit të ofertës nënkupton që oferta e tenderuesit menjëherë do të eliminohet si e papërgjegjshme. Në rastin konkret kontestues është vetëm fakti nëse AK është dashur që parashtruesve do të duhej të ju dërgonte kërkesën për konfirmimin e validitetit të ofertave të tyre jo vetëm përmes emailit por edhe përmes platformës eprokurimi. Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh faktin që AK të gjithë parashtruesve ju ka dërguar kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës në formën e njëjtë dhe në kohën e njëjtë respektivisht kërkesa është dërguar me shkrim përmes emailit zyrtar. Përndryshe as vet parashtruesit nuk e kontestojnë që e kanë pranuar kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës por vetëm pretendojmë që kërkesën në fjalë nuk e ka kanë parë me kohë. Pra AK nuk ka ngarkuar kërkesën për disa OE në platformë dhe kërkesën për disa OE të tjerë në formë tjetër mirëpo kërkesën për të gjithë OE e ka dërguar në formën e njëjtë. Ndërsa sa i përket pjesës që parashtruesit nuk kanë arritur që të evidentojnë me kohë kërkesën e pranuar nga AK përmes emailit, duhet sqaruar se edhe në rastet kur AK e ngarkon një dokument përmes eprokurimit, sërish njoftimi do të vjen përmes emailit që është regjistruar në llogarinë përkatëse të prokurimit. Pra rreziku që të mos vërehen me kohë emailët që pranohen qoftë nga AK apo nga eprokurimit ekziston gjithmonë. Si i tillë ky fakt nuk përbën argument të mjaftueshëm për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Natyrisht që krejt tjetër situatë do të ishte nëse AK nuk do të dërgonte fare kërkesën apo të njëjtën t'a dërgonte me vonesë. Përtej këtij fakti, kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim nuk mund të injorohet apo të abstrahohet faktin që parashtruesit nuk kanë vazhduar me kohë validitetin e ofertave të tyre dhe rrjedhimisht për një periudhë të konsiderueshme kohore nuk kanë poseduar validitet të ofertave përkatëse. Përmes nenit 30.6 të RRPP është përcaktuar që mos-zgjatja e validitetit të tenderit do të nënkupton eliminimin e ofertës si të papërgjegjshme. Nga ky këndvështrim kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim nuk mund të ndryshonte epilogun e aktivitetit të prokurimit. Ndërsa pretendimet ankimore të parashtruesve janë të bazuara vetëm pjesërisht. Pavarësisht kësaj, AK duhet të ketë parasysh që gjithmonë duhet të shfrytëzojë platformën eprokurimi për publikimin e shkresave apo parashtrësive të ndryshme, përpos në rastet kur ekzistojnë arsye që të përdoren edhe format tjera të komunikimit sikurse në

rastin konkret.

**Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Inline Engineering” Sh.P.K.** sipas ankesës 2024/0855 është gjetur si në vijim: Paneli Shqyrtues pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sipas të cilit arsyetimi i AK në letrën standarde për eliminimin e parashtruesit është mjaft i përgjithësuar dhe nuk përmban detaje specifike. Paneli Shqyrtues po ashtu pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues sipas të cilit AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë lidhur me dokumentet që parashtruesi ka prezantuar sa i përket stafit profesional. Tutje Paneli Shqyrtues ka konfirmuar se parashtruesi sa i përket pajisjeve të referuara në marrëveshjen për qira me “Company Murseli” nuk ka prezantuar asnjë dëshmi të pronësisë sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtruesit referuar tenderuesit të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konsideron se këto pretendime janë të pabazuara për arsyet e elaboruara si më sipër. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit janë vetëm pjesërisht të bazuara. Megjithatë Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe faktin që ofertat e parashtruesit për lot 2, 3 dhe 4 janë dukshëm më të shtrenjta sesa ofertat e tenderuesve të rekomanduar për këto lote. Si shembull parashtruesi për lot 2 ka ofertuar me 589.17 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 456.76 euro. Për lot 3 parashtruesi ka ofertuar me 565.97 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 328.23 euro. Ndërsa për lot 4 parashtruesi ka ofertuar me 582.92 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 247.61 euro. Prandaj cilido rivlerësim i aktivitetit të prokurimit nuk do të mund të ndryshonte epilogun përfundimtar të procedurës përderisa parashtruesi ka dorëzuar ofertë dukshëm më të shtrenjtë në secilin lot ndërsa kriteri i dhënies së kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” Lot 2, 3 dhe 4 me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli

Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit, duke iu terhekur vërejtje për shkak të mos respektimit të afatëve kohore sa i përket validitetit të ofertave lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - RISAMONT SH.P.K., MB POWER L.L.C., BESA COMPANY SH.P.K., INLINE ENGINEERING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: